



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje me nënparagrafin 4, paragrafi 6 i nenit 21 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP), me datën 12.07.2024, merr këtë:

VENDIM

Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS

- I. Subjektit politik INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS, i shqiptohet gjoba në vlerë katër mijë (4,000) euro për shkeljen sipas nënparagrafit 4, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.
- II. Subjekti politik INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën e gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- III. Nëse subjekti politik INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS, nuk paguan gjobën brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit të Zyrës, subjektit politik nuk i transferohen mjetet financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politik në shumën e gjobës së shqiptuar.
- IV. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

Arsyetim

Subjekti politik INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS, është subjekt politik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi nga data 21.08.2000.

Nenit 15 i LFSP thekson qartë që raportet vjetore financiare të subjekteve politike duhet të përmbajnë dokumentacionin mbështetës për secilin shpenzim.

Me datën 17.10.2023, nga llogaria bankare e subjektit politik, janë tërhequr mjete financiare në vlerën (dy mijë) 2,000 euro, për të cilën tërheqje është dhënë arsyetimi për pagesën e faturave. Për tërheqjen e mjeteve financiare, subjekti politik nuk ka ofruar dokumentacion mbështetës që e arsyetojnë shpenzimin apo pagesën e faturave në fjalë.

Dështimi për të prezantuar dokumentacionin mbështetës për shpenzimet e bëra nga subjekti politik paraqet shkelje të nenit 15 të LFSP dhe dënohet në përputhje me nënparagrafin 4, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.

Subjekti politik INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS, obligohet që pagesën e gjobës sipas pikës I të këtij vendimi, ta kryejë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Pagesa e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë. Në rast të dështimit të pagesës së gjobës brenda afatit të dhënë si në pikën II të këtij vendimi, subjektit politik nuk i transferohen mjetet financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politik në shumë e gjobës së shqiptuar.

Nga sa u tha më lartë, Zyra vendos për shqiptimin e gjobës në vlerë prej katër mijë (4,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Prishtinë, 12.07.2024

Drejtori i Zyrës



Besnik Buzhala
Besnik Buzhala

The image shows a circular official stamp in blue ink. The text around the perimeter of the stamp reads "KOMISIONI I ZGJEDHJEVE - QEVERIA" at the top and "KOMISIONI I ZGJEDHJEVE - QEVERIA" at the bottom. In the center of the stamp, there is a handwritten signature in blue ink that appears to be "Besnik Buzhala". Below the signature, the name "Besnik Buzhala" is printed in a bold, black font.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të subjektit politik INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS.
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politik INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS.

Këshilla juridike: Subjekti politik mund të inicojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.